



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË
SEKRETARI

Nr 3131 / Prot. 22

Divjakë më 29 / 04 / 2025

Lënda. Dërgim i Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë, për zbatim, të mbledhjes së muajit
Prill më datë. 24.04.2025.

SEKTORIT JURIDIK PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

BASHKIA DIVJAKË

Mbështetur në nenin 53,54,55, pika 6, të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 8, gërma a,b, si dhe në shkresën e ardhur nga Prefektura e Qarkut Fier me nr **386 dt 24.04.2019** “*Mbi sjelljen në vëmendje të disa përcaktimeve ligjore*, ku Prefekti i Qarkut si kompetencë kryesore në lidhje me NjVQV ka verifikimin ligjor **vetëm të Akteve Normative**, sipas nenit 16 të Ligjit nr 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” po **Ju** dërgojmë Vendimet e Këshillit Bashkiak Divjakë, **për zbatim**, të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak datë **24.04.2025**, si vijon :

1. **Vendim nr 23 datë 24.04.2025**: Për krijimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Rrjela” shpk, dhe miratimin e Statutit dhe Aktit të themelimit.

Bashkëngjitur është Vendimi nr.23 datë 24.04.2025.

Sqarim.

Vendimi Nr. 23 datë 24.04.2025. **nuk dërgohet** në Prefekturë, sepse nuk është akt normativ, zbatohet 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Mimoza Thomaj



SEKRETARAT
BASHKIAK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 3131 / Prot. 118

Divjakë më 24 / 04 / 2025

VENDIM

Nr. 23, datë 24 . 04 . 2025

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RRJELA” SH.P.K.DHE MIRATIMIN E STATUTIT DHE AKTIT TË
THEMELIMIT”**

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.6 shkronja “b”, nenit 23, nenit 26, nenit 33, pika 1 shkronja “d”, neni 54, shkronja “d” të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Projektvendimit të paraqitur nga Bashkia, Këshilli i Bashkisë Divjakë, më datë, 24.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “RRJELA” sh.p.k., me kapital fillestar me një vlerë prej 10 000 (dhjetëmijë) lekë, me objekt veprimtarie siç përshkruhet në Aktin e themelimit, bashkalidhur këtij vendimi (neni 4),
2. Bashkia Divjakë është zotëruese e 100% të kuotave, të cilat përbëjnë kapitalin e themeltar të “RRJELA” sh.p.k., me një vlerë prej 10 000(dhjetëmijë) Lekë, e barabartë me 1(një) kuotë.
3. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë “RRJELA” sh.p.k. bashkëlidhur këtij vendimi Shtojca nr. 1.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij të përfaqësojë Bashkinë për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për themelimin e shoqërisë “ RRJELA” sh.p.k sipas përcaktimeve të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 10.000(dhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2025 dhe Bashkia Divjakë e transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie, menjëhere pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bashkia e Divjakës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “Rrjela” shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



6. Shoqëria "Rrjela" shpk, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.
7. Bashkia Divjakë i siguron shoqërisë "Rrjela" shpk, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, sipas objektit të saj.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Sektori Juridik, Prokurimeve Publike dhe menaxhimit të aseteve pranë Bashkisë Divjakë.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ana Nako

